

**Informacione për të huajt  
e sapoardhur në kantonin Uri**

*Mirë se,  
vini tek ne!*



## Pasqyra e lëndës

Parathënie	3
Tri nivelet administrative të Zvicrës	4
Uri	5
Vlerat themelore	6
Rregullimi i qëndrimit	7
Banimi	8
Puna	10
Taksat	12
Siguria sociale	13
Shëndeti	15
Shkolla dhe arsimi	16
Fëmija	19
Martesa, lindja dhe vdekja	20
Jeta e përditshme dhe koha e lirë	22
Mobiliteti	23
Gjuha dhe ofertat për mësimin e gjuhës	24
Ditët e festave	25
Adresa ndihmëse	26

01.01.2016

## Willkommä bi yys!



Mirë se erdhët tek ne!

Ju keni vendosur që të jetoni në Uri . Kjo na gëzon! Sepse kantoni ynë ka një traditë shekullore, të strehojë njerëz të huaj.

Falë pozicionit pranë qafës Gotthard, Uri është prej kohësh një vend i rëndësishëm evropian i transimit. Miliona njerëz kalonin gjatë historisë nga Uri; disa kanë qëndruar. Me idetë e tyre dhe me dinamizmin e tyre ata kanë kontribuar, që ta bëjnë Uri atë që është sot: një pjesë moderne dhe e gjallë e Zvicrës. Uri ofron pozicione të bukura të banimit, lidhje të mira qarkullimi dhe një sistem të shkëlqyer arsimor – të vendosura në një peizazh malor mahnitës.

Njerëzit në këtë kanton të bukur rrjedhin nga kultura të ndryshme. Por në një klimë të tolerancës dhe të çiltërsisë të gjithë respektojnë njëri-tjetrin. Ne kemi një ndjenje të theksuar për shoqërinë. Prandaj në Uri ka qat shumë shoqata. Ato ofrojnë mundësi të panumërta që të krijohen dhe të mbahen kontakte personale.

Shfrytëzoni mundësitë e tilla. Ne dëshirojmë që shpejt të ndiheni mirë tek ne dhe të merrni pjesë aktivisht në shoqëri. Ne dëshirojmë që ju të keni sukses, si në sferën profesionale, ashtu edhe në jetën private dhe që ju të sillni idetë tuaja dhe dinamizmin tuaj për zhvillimin e kantonit tonë. Kjo broshurë duhet t' ju mbështesë gjatë kësaj dhe duhet t' ju japë informacionet më të rëndësishme për kantonin tuaj Uri.

Beat Jörg

Këshilltar qeveritar



## Tri nivelet administrative të Zvicrës

Zvicra është e ndarë në 26 kantone dhe njihet edhe si Federatë apo Konfederatë.

Kantoni Uri është i ndarë në 20 komuna. Konfederata dhe komunat kanë detyra të ndryshme.

### **?** Cilat janë detyrat e konfederatës?

Konfederata kryen detyra të cilat për krejt Zvicrën janë të rregulluara njëjloj. Kjo vlen p.sh. për politikën e jashtme apo rregullimin e qëndrimit të të huajave dhe të huajve.

### **?** Cilat janë detyrat e kantonit?

Kantoni merr përsipër detyra që vlejnë për të gjitha komunat. Për shembull kujdesin spitalor, policinë apo arsimin profesional.

### **?** Cilat janë detyrat e komunave?

- Regjistrimi i të gjithë banoreve dhe banorëve
- Organizimi i shkollimit fillor në shkallën primare dhe sipërore
- Sigurimi i ndihmës sociale për banoret dhe banorët e tyre
- Sigurimi i infrastrukturës si furnizimi me ujë dhe largimi i mbeturinave
- Të tjera

### **?** Kush e përcakton veprimtarinë e konfederatës?

Qytetarët dhe qytetarët zviceranë kanë të drejta të gjëra demokratike. Ata nuk zgjedhin vetëm parlamentet dhe qeveritë e tyre, por vazhdimisht vendosin edhe për çështje substanciale.

### 3 Informacione për kantonin e Urit

#### **Kantonale Verwaltung Uri**

6460 Altdorf


Telefon: 041 875 22 44

E-mail: [info@ur.ch](mailto:info@ur.ch)

[www.ur.ch](http://www.ur.ch)

**A e keni ditur që kantoni Uri krahas Schwyz, Obwalden dhe Nidwalden është njëri prej kantoneve të themelimit të konfederatës së parë zvicerane?**

## Uri



Faqet e internetit të komunave:  
[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > Behörden > Gemeinden

A keni ditur se Uri kufizohet me kantonet  
 Graubünden, Tessin, Wallis, Bernë, Obwalden,  
 Nidwalden, Schwyz dhe Glarus?

## Vlerat themelore

### **?** Cilat janë të drejtat dhe detyrimet e mia?

Zvicra dhe me këtë edhe kantoni Uri i i venë rëndësi lirisë, të drejtave dhe respektimit të detyrimeve të çdo individit. Parakusht për këtë janë respekti dhe toleranca e ndërsjellë si dhe njohja e vlerave të ndërsjella themelore në bashkëjetesë.

#### **Vlerat thelbësore themelore dhe të drejtat:**

- Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm.
- Të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit
- Gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta
- Të drejtat e lirisë
- Të drejtat e lirisë së individit përfundojnë aty ku fillojnë të drejtat e lirisë së të tjerëve

#### **Detyrimet thelbësore:**

- Detyrimi tatimor
- Kontraktimi dhe pagesa e shërbimit shëndetësor
- Pagesa e kontributeve sociale nga të punësuarit dhe të pasurit
- Respektimi i detyrimit shkollor dhe bashkëpunimi me shkollën dhe mësuesit

### **?** Çfarë pritet nga të sapoardhurat dhe të sapoardhurit?

Në Kantonin e Urit pritet që ju të merrni pjesë në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Është e nevojshme që ju të merreni me raportet shoqërore dhe kushtet e jetesës në Zvicër dhe, në veçanti, të mësoni gjuhën gjermane.

#### **Për këtë ju keni shumë mundësi:**

- të kultivoni fqinjësinë
- të jeni anëtar i ndonjë shoqate
- të merrni pjesë në aktivitetet e komunës ose të kantonit
- të merrni pjesë në traditat e Urit
- të bëni punë vullnetare në fushën kulturore, sportive dhe sociale
- të ndiqni një kurs të gjuhës gjermane

**Informacione për federatën  
dhe kushtetutën e federatës:**  
[www.admin.ch](http://www.admin.ch)

**Informacione për Zvicrën:**  
[www.ch.ch](http://www.ch.ch)

**A keni ditur se 50% e popullsisë zvicerane  
merr pjesë aktivisht në ndonjë klub?**

## Rregullimi i qëndrimit

### **?** Çfarë duhet të rregulloj unë?

Persona të huaj me një leje të vlefshme për hyrjen, ardhjen ose qëndrimin, të cilët dëshirojnë të qëndrojnë afatgjatë në kanton Uri, duhet të regjistrohen brenda 14 ditëve tek Zyra e kontrollit të banorëve të komunës suaj të re të banimit. Më përpara ju duhet të çregjistroheni nga vendbanimi i vjetër. Për regjistrimin janë të nevojshme leja e hyrjes, ardhjes ose qëndrimit, dy fotografi dhe pasaporta ose karta e identitetit. Pas regjistrimit autoriteti i migrimit do t' ju lëshojë një leje të re qëndrimi.

### **?** Çfarë duhet të lajmëroj unë tek autoritetet e vendbanimit tim?

- Ndërrimin e vendbanimit brenda kantonit apo komunës
- Të çregjistrohem në rast të ndërrimit të kantonit/shpërnguljes

### **?** Çka duhet të lajmëroj tek Enti Kantonal i Punësimit dhe Migrimit?

- Qëndrimet jashtë shtetit që zgjasin më shumë se 6 – të muaj



### **?** A mundet familja ime gjithashtu të vijë?

Nëse jeni nga një shtet i BE-së/ EFTA-s [Organizata Evropiane për Tregti të Lirë], ju mundeni që anëtarët e familjes suaj t'i vendosni në Zvicër, me kusht që ju të posedoni një banesë të përshtatshme.

Si pjesëtarë të familjes vlejné bashkëshortët, prindërit dhe fëmijët, të cilët nuk janë akoma 21 vjeç ose mjetet e jetesës së tyre janë të siguruara. Gjithashtu prindërit dhe gjyshi e gjyshja, nëse mjetet e jetesës së tyre janë të siguruara.

Studentëve që u lejohet studimi, munden të tërheqin bashkëshortët dhe fëmijët vetëm atëherë, nëse mjetet e jetesës së tyre janë të siguruara.

Nëse ju jeni nga një shtet jashtë BE-së dhe EFTA-s mund të tërhiqni familjen dhe fëmijët tuaj beqarë nën 18 vjeç, nëse familja banon bashkë dhe ekziston një banesë e përshtatshme. Nëse ju jeni të varur nga ndihmat sociale, një bashkim familjar nuk është i mundshëm.

E drejta për bashkim familjar duhet të ushtrohet brenda pesë vjetësh. Fëmijët mbi dymbëdhjetë vjeç duhet të tërhiqen brenda dymbëdhjetë muajve.

Enti për punë dhe migrim/Seksioni i migrimit  
**Amt für Arbeit und Migration/Abteilung Migration**  
[www.ur.ch/migration](http://www.ur.ch/migration)

Sekretariati i Shtetit për Migrim (SEM)  
**Staatssekretariat für Migration (SEM)**  
[www.bfm.admin.ch](http://www.bfm.admin.ch) > Themen > Einreise  
[www.bfm.admin.ch](http://www.bfm.admin.ch) > Themen > Aufenthalt

**A keni ditur se rregullimi i qëndrimit është çështje e personit të ardhur?**

## Banimi



### Si mund të gjej një banesë me qira?

Banesa me qira mund të gjeni nëse:

- i lexoni reklamën në gazeta dhe në fletushkën falas në «Uristier» apo
- lexoni në faqet e specializuara të internetit,
- apo pyesni direkt tek agjencitë e pasurive të patundshme.



### Çfarë është e rëndësishme që të dini si qiramarrës i një objekti të banimit?

Zakonisht nënshkruhet një kontratë qiraje me shkrim, e cila përmban hapësirën e objektit të marrë me qira, datat e anulimit, kaucionin e qirasë, kushtet e përgjithshme dhe rregulloren e shtëpisë.

Qiraja, si rregull, paguhet për muajin e ardhshëm. Në të shumtën e rasteve qiramarrësi paguan harxhime shtesë, si p.sh., për ngrohje, ujë apo televizion kabllor.

Informohuni, nëse shpenzimet e qirasë suaj përmbajnë pagesat e rregullta apo edhe pagesat shtesë (Nebenkosten)!

Në rast të dorëzimit-pranimit të banesës gjatë hyrjes ose largimit nga banesa rekomandohet që së bashku me pronarin e banesës të kontrolloni gjendjen e banesës dhe ndonjë defekt apo mungesë të mundshme ta protokolloni me shkrim (edhe dëmet e vogla!).

Kaucioni i qirasë është një shumë prej maksimum tri qirave mujore të shumës së qirasë, që për siguri të qiradhënësit paguhet paraprakisht në xhirollogarinë për depozitimin e qirasë. Xhirollogaria është në emër të qiramarrësit. Me largimin e tij, ai e merr kaucionin mprapsht së bashku me interesat, nëse nuk ka ndonjë mosmarrëveshje me pronarin në lidhje me dorëzimin e banesës.

Është e këshillueshme që për objektin e marrë me qira të kontraktohet një sigurim i përgjegjësishë ndaj palës së tretë.

Përveç qirasë qiramarrësi duhet të paguajë tarifa për shfrytëzim të valëve nga aparatet me të cilat është e mundur të shfrytëzohen programe të radio dhe TV (p.sh. TV, radio makine, apo telefonat celularë). Qiramarrësi vetë e ka për detyrë që të regjistrohet tek Agjencia Zvicerane e Mbledhjes së Taksave (BILLAG).

#### **BILLAG Zvicër BILLAG Schweiz**

Infoline: 0844 834 834

E-mail: info@billag.com, www.billag.ch



### Çfarë duhet të kem parasysh, kur jetoj në një banesë me qira?

Në shumicën e shtëpive apo banesave me qira ka rregullore shtëpiake që duhet të respektohen. P.sh. duhet të respektohet qetësia e natës nga ora 22.00 deri në orën 07.00 të mëngjesit dhe qetësia e drekës nga ora 12.00 deri orën 13.00. Gjithashtu në ditët e diela dhe ato të festave duhet të shmangët zhurma.

Kush dëshiron të festoj është mirë që për këtë t' i njoftojë fqinjët e vetë!

Hapësirat e përbashkëta si ambienti për larjen e rrobave, shkallët, zonat e parkimit apo ashensori nuk duhet të bllokohen me sende të veta dhe duhet të mbahen të pastër. Për përdorim e një ambienti të përbashkët për larjen e rrobave, në të shumtën e rasteve ka një plan të përdorimit.

Në shumë shtëpi pirja e duhanit në ambientet e përbashkëta është e ndaluar!

Në rast të konflikteve me pronarin në dispozicion tuajin janë Shoqata e Qiramarrësve si dhe autoriteti i pajtimit.



#### **Shoqata e qiramarrësve**

##### **Mieterinnen und Mieterverband Luzern**

Hertensteinstrasse 40, 6004 Luzern

Telefon: 041 220 10 22 (9 bis 12 Uhr)

mvlu@bluewin.ch / www.mieterverband.ch

#### **Autoriteti kantonal i pajtimit në çështjet civile**

##### **Kantonale Schlichtungsbehörde in Zivilsachen**

Bahnhofstrasse 43, 6460 Altdorf

Telefon: 041 875 22 90

E-mail: schlichtungsbehoerde@ur.ch

www.ur.ch > Behörden > richterliche Behörden

**A keni ditur se rreth 60% e popullsisë zvicerane jetojnë në një banesë me qira?**



## Banimi



### Si duhet t'i hedh mbeturinat e mia?

Në Zvicër trajtimit në mënyrë ruajtëse të mjedisit i kushtohet rëndësi e veçantë. Kjo tregohet edhe me riciklimin e mbeturinave. Mbeturinat ndahen dhe pjesët e mbetura të hedhurinave të shtëpisë futen në thasë me detyrim pagese dhe në interval javor mblidhen dhe transportohen.

Rreth mundësive të hedhjes së mbeturinave si dhe për të dhënat e ndarjes së hedhurinave ju informoheni nga komuna juaj e banimit.

ÇFARË	KU	SI (KUR)	ÇMIMI
<b>Thesi i shtëpisë</b>	hedhja (në ZAKU-thasë)	të vendoset përskaj rrugës (çdo javë*)	të blihen thasë prej 35/60/110L
<b>Hedhurinat e kopshtit</b>	hedhja (kontejneri i gjelbër)	të vendoset përskaj rrugës (çdo 2 javë*)	falas
<b>Qelqi</b>	vende grumbullimi të veçanta*	secila ngjyrë, veç e veç	falas
<b>PET (shishet e pijeve)</b>	shitoret	ajri duhet nxjerrë nga shishja	falas
<b>Kanoçet</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	të pastrohen	falas
<b>Bateritë</b>	shitoret	apo vendet e veçanta të grumbullimit	falas
<b>Letrat</b>	hedhja	të lidhura vendosen përskaj rrugë (afërsisht çdo 2 muaj*)	falas
<b>Karton</b>	hedhja	të lidhura me penj, të vendosen afër rrugës (afërsisht çdo 2 muaj*)	falas
<b>Tekstilet</b>	Kontejnerët – Texaid*	të futen në thasë	falas
<b>Aparatet elektronike</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	detyrim kthimi	falas
<b>Helmet</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	deri 10kg/ bartja	falas
<b>Vaji</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	llojet e vajrave të ndahen!	falas
<b>Coftinat</b>	Vend grumbullimi për coftina <sup>1</sup>	deri në 200kg, përndryshe të transportohet	falas
<b>Këpucët</b>	Kontejnerët – Texaid*	të lidhura në palë	falas
<b>Poçet/Dritat</b>	shitoret	mos e fut në thes!	falas
<b>Mallrat e rënda</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	mos e fut në thes!	Fr –.50/kg
<b>Sterepoli /polisteroli</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	mos e fut në thes!	2. Fr kg
<b>Mbeturinat nga ndërtimi</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	mos e fut në thes!	10. Fr kg
<b>Boileri</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	mos e fut në thes!	50. Fr / 1 copë
<b>Hedhurinat e drurit</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	mos digjet!	25. Fr kg
<b>Motoçikleta</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	pa benzinë dhe vaj	10. Fr. / 1 copë
<b>Gomat</b>	vendet e veçanta të grumbullimit*	deri në 70 cm perimetër 7. Fr. / 1 copë	me bandazh, pa bandazh 4. Fr. / 1 copë.

\* të dhënat dhe vendet specifike të grumbullimit komunal shih [www.zaku.ch](http://www.zaku.ch)

#### Informacione për

«Mbeturinat dhe riciklimin» në gjermanisht:

[www.abfall.ch](http://www.abfall.ch)

Informacione për «Menaxhimin e mbeturinave në Uri» në gjermanisht:

[www.zaku.ch](http://www.zaku.ch)

**A e keni ditur se përmes riciklimit të mbeturinave kursehet energji, rifitohen lëndë e para dhe krijohen vende të reja pune?**

## Puna

### ? A më duhet një leje pune?

Si qytetar apo qytetare e BE-së/EFTA-s keni të drejtë qasjeje në tregun zviceran të punës si punëmarrës në të gjitha profesionet dhe kualifikimet. Njohja e diplomës është e rregulluar.

### ? Çfarë të drejtash dhe detyrimesh kam unë si punëmarrës?

#### Punëmarrësit kanë të drejtë:

- për rrogën e rregulluar me marrëveshje
- për të paktën 4 javë pushim vjetor
- për një dëftesë pune
- për mbrojtjen e personalitetit
- për një muaj kohë prove, nëse nuk është bërë një marrëveshje tjetër

#### Punëmarrësit kanë detyrim:

- që t'i respektojnë udhëzimet e punëdhënësit
- për përkujdesje dhe besnikëri që ta kryejnë punën sipas marrëveshjes

### ? Çfarë përmban kontrata e punës?

Informacione mbi përmbajtjen e kontratës së punës mund të gjeni tek 'Informacione mbi kushtet e punës'.

Parimisht një kontratë pune është e mundur të bëhet edhe gojarisht. Mirëpo rekomandohet gjithmonë që të lidhet një kontratë pune me shkrim.

Në shumë degë apo në ndërmarrje të mëdha të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit janë të rregulluara në kontrata kolektive (GAV).

Për grupe të veçanta të profesioneve, autoritetet lëshojnë të ashtuquajtura kontrata normale të punës (NAV). Shumica e këtyre kontratave NAV janë të rregulluara në bazë kantonale.

Informohuni se si është e rregulluar kjo në profesionin tuaj.



### ? Si është i rregulluar anulimi i kontratës së punës?

Afati i anulimit zakonisht rregullohet përmes kontratës së punës, kontratës normale të punës së llojit të profesioneve përkatëse apo përmes kontratës kolektive. Afatet për të dyja palët janë të njëjta.

Nëse mungon një marrëveshje, atëherë vijnë në zbatim dispozitat e të drejtës së obligacioneve (OR)

- Gjatë afatit të provës: shtatë ditë pune
- Gjatë vitit të parë të punës: një muaj, në fund të një muaji
- Nga viti i dytë deri në vitin e nëntë të punës: dy muaj, në fund të një muaji
- Nga viti i dhjetë i punës: tre muaj, në fund të një muaji.



**Informacione mbi kushtet e punës:**  
[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «Arbeitsbedingungen»

**Informacione për të drejtën e punës, kontratat kolektive, kontratat normale dhe sfera të tjera rreth temës së punës:**  
[www.seco.admin.ch](http://www.seco.admin.ch) > Arbeitsrecht

## Puna



### Kur jam i mbrojtur nga anulimi i kontratës?

Punëdhënësit nuk duhet ta anulojnë kontratën e punës me punëmarrësit, nëse këta gjenden në këto situata: Kur është i sëmurë apo ka pësuar fatkeqësi, gjatë shtatzënisë dhe lindjes, gjatë pjesëmarrjes në ndonjë aksion ndihmues të federatës jashtë vendit, në shërbim ushtarak prej të paktën njëmbëdhjetë ditësh, në mbrojtje civile apo në shërbimin e Kryqit të Kuq.



### Sa është koha mesatare e punës?

Mesatarisht njeriu në Zvicër punon 42 orë në javë. Numri i orëve të punës varet nga punëdhënësit, nga angazhimi dhe profesioni. Orari i punës shënohet në kontratë.

Orari javor i punës për punëtorët e industrisë, personelin e zyrave, personelin teknik dhe nëpunës të tjerë si punëtorët e shpërndarjes personeli i shitjes në sipërmarrje të mëdha është i kufizuar në një maksimum prej 45 orësh. Për të gjithë punëmarrësit e tjerë vlen një orar i punës prej maksimumi 50 orësh në javë.

#### RAV Qendra Rajonale për Ndërmjetësim Pune Uri

##### RAV Regionales

##### Arbeitsvermittlungszentrum Uri

Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf

Telefon: 041 875 24 39

E-mail: [arbeit.migration@ur.ch](mailto:arbeit.migration@ur.ch)

[www.treffpunkt-arbeit.ch](http://www.treffpunkt-arbeit.ch)

#### Enti për punë dhe migrim

##### Amt für Arbeit und Migration

Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf

Telefon: 041 875 24 18

E-mail: [arbeit.migration@ur.ch](mailto:arbeit.migration@ur.ch)

[www.ur.ch/arbeit](http://www.ur.ch/arbeit)

#### Lidhja e Sindikatave

##### Gewerkschaftsbund

Sekretariat, Reto Röthlin

Sonneggstrasse 1, 6463 Bürglen

Telefon: 041 870 13 16

E-Mail: [reto.roethlin@bluewin.ch](mailto:reto.roethlin@bluewin.ch)

Schweizer Gewerkschaftsbund: [www.sgb.ch](http://www.sgb.ch)



### Nga se përbëhet rroga ime?

Paga zakonisht faktohet në një llogari të pagës. Në të janë të shënuara hollësisht të gjitha ndalesat, shtesat, paga bruto dhe neto. Shtesat e pagës mund të jenë p.sh. shtesat për fëmijë Ndalesat bëhen për Sigurimin e Pleqërisë dhe Pasardhësit (AHV) Sigurimin e invaliditetit (IV), Sigurimin plotësues në rast papunësie (EO), Sigurimin e papunësisë (ALV), Sigurimin për fatkeqësi jashtë punës (NBU) dhe Arkën Pensionale (PK). Nga paga tërhiqen tatimi në të ardhura apo taksa vjetore!

Kontributet për sigurimin shëndetësor në Zvicër nuk janë pjesë e ndalesave në pagë. Shih «Shëndetësia»



### Çfarë mund të bëj unë, nëse unë jam i papunë?

Lajmërohuni në Qendrën Rajonale për Kërkim të Punës (RAV). Atje do të merrni mbështetje.

Po ashtu duhet të filloni menjëherë të kërkoni një vend pune. I ruani dëshmitë e letrave për kërkim pune. Për të marrë asistencë papunësi ju duhet të dëshmoni që jeni përpjekur seriozisht për të gjetur një vend të ri të punës dhe i plotësoni kushtet për të drejtën e shfrytëzimit.

Më shumë informacione mund të merrni tek RAV Uri.

**A keni ditur se puna e zezë e dëmton mbrojtjen e punëmarrësit?**

## Taksat

Në Zvicër kostot e shërbimeve publike si infrastruktura, komunikacioni, ushtria, policia, arsimi, shëndetësia, sigurimi social, kultura dhe sporti, paguhen kryesisht nga të hyrat tatimore të personave privatë, tatimi i firmave dhe tatimi i vlerës së shtuar (TVSH).

Taksa mbi të ardhurat dhe mbi pasurinë kërkohen në Zvicër si nga federata (taksë federale), ashtu edhe nga kantonet dhe komunat (taksa kantonale dhe komunale).

Secili nga 26 kantonet ka një ligj të vet për tatimet dhe i ngarkon të ardhurat dhe pasuritë në masa të ndryshme. Prandaj ngarkesa tatimore në Zvicër ndryshon në lartësi nga kantoni në kanton dhe nga komuna në komunë.

### Tatimi në burim për punëmarrësit e huaj me vendbanim në Zvicër

Të gjithë punëmarrësit e huaj, të cilët nuk e posedojnë lejen e vendosjes C, i nënshtrohen tatimit në burim. Punëdhënësit janë të detyruar që t' i heqin tatimet e detyruara direkt nga rroga (nga burimi). Tatimi në burim përfshin tatimet kantonale dhe komunale, tatimin direkt të federatës dhe eventualisht edhe tatimet e kishave.

### Në rast të tarifave të zbatueshme dallohet si më poshtë:

- Tarifa A për personat e tatueshëm që rrinë me vete
- Tarifa B për persona të tatueshëm që janë martuar (i vetmi njeri me të ardhura); tarifa varet nga numri i fëmijëve («pa fëmijë», «me 1 fëmijë», «me 2 fëmijë» etj.)
- Tarifa C për persona të tatueshëm që janë martuar (çift me dy të ardhura); tarifa varet nga numri i fëmijëve («pa fëmijë», «me 1 fëmijë», «me 2 fëmijë» etj.)
- Tarifa D për të ardhurat nga puna dytësore; tarifë e veçantë

Në rast të rrogave mbi 120'000 franga bëhet një llogaritje e rregullt në retropektivë. (shih edhe shtjellimet vijuese)



### Vlerësimi i rregullt tatimor për personat me lejen e vendosjes C ose një rrogë prej më shumë se 120'000 frangave

Personat me vendbanim në Zvicër, pavarësisht nga lartësia e të ardhurave të tyre, duhet të deklarojnë në përputhje me të vërtetën të gjithë të ardhurat (vërtetimi i pagës, fitimi nga pasuria etj.) dhe shpenzimet lidhur me veprimtarinë profesionale. Deklarata tatimore duhet të dorëzohet tek zyra e tatimit të komunës.

Zyra e tatimit i përcakton faktorët e tatimit (mbi të ardhurat dhe mbi pronësinë) një herë në vit. Tatimet për personat privatë mblihen në vendbanim dhe duhet të paguhen një herë në vit.

Informacione mbi temën e tatimit:

[www.ur.ch/steuern](http://www.ur.ch/steuern)

**A e keni ditur se Zvicra, për të shmangur tatimin e dyfishtë të të huajve në Zvicër, me shumë shtete ka bërë marrëveshje bilaterale mbi tatimin?**

## Siguria sociale



### Çfarë do të thotë nocioni «Siguria sociale»?

Një rol i rëndësishëm në sistemin kompleks të sigurisë sociale luajnë sigurimet e ndryshme shoqërore. Ato të gjitha bashkë me ndihmën sociale publike bëjnë që qytetarët dhe qytetarët të ruhen nga gjendjet e vështira (financiare).

«Siguria sociale» i mbulon këto rreziqe:

- Përkujdesjen mjekësore në rast sëmundjeje dhe aksidenti
- Humbjen e fitimit në rast të sëmundjes, aksidentit dhe të amësisë.
- Pleqërinë, vdekjen dhe invaliditetin
- Papunësinë
- Ngarkesat familjare

### Parimi i tri shtyllave

Kushtetuta federale e detyron federatën të marrë masa për përkujdesjen e mjaftueshme në pleqëri, për të pasjetuarit dhe në rastin e invaliditetit. Këto bazohen në tri shtylla:

Shtyllën e 1-rë e formon sigurimi i pleqërisë dhe për të pasjetuarit (AHV), sigurimi i invaliditetit (IV) dhe sigurimi për përfitime plotësuese (EL). Ato e sigurojnë nevojën ekzistenciale për të moshuarit, të pasjetuarit dhe invalidët. Një e drejtë për EL ekziston, nëse mbajtja me të holla nuk mund të financohet me të ardhurat (pensioni, rroga) dhe me pasurinë.

Shtylla e 2-të është përkujdesja profesionale për kohën pas pensionimit ose për rastin e invaliditetit. Me atë duhet të garantohet vazhdimi i standardit të zakonshëm të jetesës.

Shtylla e 3-të i përket përkujdesjes private dhe është vullnetare. Për të punësuarit e pavarur shtylla e 3-të mund të shërbejë si zëvendësim për shtyllën e 2-të.



#### Arka e Kompensimit:

#### Sozialversicherungsstelle Uri

Dätwylerstrasse 11, 6460 Altdorf

Telefon: 041 874 50 20

E-Mail: [info@svsuri.ch](mailto:info@svsuri.ch)

[www.sozialversicherungsstelleuri.ch](http://www.sozialversicherungsstelleuri.ch)

#### Informacione për AHV/IV:

[www.ahv-iv.info](http://www.ahv-iv.info)

## SISTEMI I TRI SHTYLLAVE

### Shtylla e 1-rë

Përkujdesje shtetërore

Sigurimi i ekzistencës

AHV / IV

Përfitime plotësuese (EL)

### Shtylla e 2-të

Përkujdesja profesionale

Vazhdim i standardeve të mëparshme të jetesës

I detyrueshëm  
BVG / UVG

Përkujdesja e mbidetyrueshme

### Shtylla e 3-të

Përkujdesje private

Plotësime individuale

Përkujdesja e lidhur me kushte (shtylla 3a)

Përkujdesja e lirë (shtylla 3b)

Informacione të mëtejshme merrni tek Zyra e sigurimeve shoqërore Uri ose degat e AHV-së së komunave.

## Siguria sociale



### Sigurimi ndaj aksidenteve

Të gjithë të punësuarit në Zvicër janë të siguruar, që nga dita e parë, në mënyrë të detyrueshme kundër aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Nëse ju punoni më shumë se 8 orë në javë, ju jeni i siguruar edhe në rast të aksidenteve jashtë vendit të punës.

Edhe ata që punojnë në shtëpitë e tyre, ndihmësit në mirëmbajtjen familjare, personeli pastrues në ekonomitë familjare private, duhet të jenë të siguruar nga punëdhënësi.

Personat e papunë janë të siguruar parimisht në mënyrë të detyrueshme.

Anëtarët e një familjeje që bëjnë punë të pavarur, që ndihmojnë në ndërmarrjen familjare, duhet që vullnetarisht të sigurohen në sigurimin profesional ndaj aksidenteve.

#### Shërbime sociale regionale:

*Sozialdienst Uri Nord* (Altdorf, Attinghausen, Bauen, Flüelen, Isenthal, Seedorf, Seelisberg, Sisikon)  
Telefon: 041 874 12 28

*Sozialdienst Uri Ost* (Bürglen, Schattdorf, Spiringen)  
Telefon: 041 874 04 66

*Sozialdienst Urner Oberland*  
(Andermatt, Erstfeld, Göschenen, Gurtnellen, Hospental, Realp, Silenen, Wassen)  
Telefon: 041 882 01 41

*Sozialdienst Unterschächen*  
Telefon: 041 879 11 66

#### Papunësia:

shih kapitullin «Puna»

#### Arka e sigurimit shëndetësor:

shih kapitullin «Shëndeti»

#### Zyra për çështjet sociale

##### Amt für Soziales

Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf  
Telefon: 041 875 21 52  
E-mail: sozialamt@ur.ch  
www.ur.ch/gsud

Të pasiguruar janë gra dhe burra shtëpiake/ë, fëmijët, studentët dhe pensionistet dhe pensionistët. Ata duhet të sigurohen ndaj aksidenteve tek arka e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm.

#### Amësia

Gratë, të cilat gjatë 9 muajve para lindjes ishin të siguruara në AHV, kanë punuar gjatë kësaj kohe të paktën 5 muaj dhe në momentin e lehonisë konsiderohen të punësuar, marrin përfitime nga sigurimi i lehonisë. Kohëzgjatja e pretendimeve është parimisht 14 javë.

#### Shtesat familjare

Shtesat familjare duhet t' i kompensojnë pjesërisht shpenzimet, të cilat i krijohen prindërve me mbajtjen e fëmijëve. Ato përfshinë shtesat për fëmijët dhe formimin arsimor si dhe shtesat e futura nga kantone të veçanta për lindjet dhe birësimet.

Në kantonin Uri shtesat për fëmijët janë 200 franga për muaj dhe fëmijë. Ato paguhen që nga muaji i lindjes deri në fundin e muajit, në të cilin fëmija e mbush moshën 16 vjeç.

Shtesat për formimin arsimor janë 250 franga për muaj dhe fëmijë. Ato paguhen që nga fundi i muajit, në të cilin fëmija e mbush moshën 16 vjeç, deri në mbarimin e formimit arsimor, mirëpo jo më gjatë sesa deri në moshën 25 vjeç.

Për shtesat familjare vlejné dispozitat përkatëse të vendit të punës. Regjistrimi dhe pagesa bëhet nëpërmjet punëdhënësve.



#### Çfarë ndodh nëse unë nuk mund ta siguroj ekzistencën time?

Në këto raste vjen në shprehje ndihma sociale. Kjo e siguron ekzistencën minimale, parandalon që persona apo grupe personash të jenë të përjashtuara nga pjesëmarrja dhe kontributi i tyre në shoqëri. Përveç ndihmës materiale (përkrahje financiare dhe kontribute të tjera në vlerë paraje), ndihma personale paraqet një pjesë të domosdoshme të orientimit të ndihmës sociale për të arritur efekte. Në një rast të tillë paraqituni tek shërbimi social i vendbanimit tuaj.

**A keni ditur se rrjeti i dendur i sigurimeve shoqërore u ofron mbrojtje nga rreziqet njerëzve që jetojnë dhe punojnë këtu si dhe të afërmve të tyre ?**

## Shëndeti

### **?** A duhet të sigurohem ndaj sëmundjeve dhe aksidenteve?

Në Zvicër lidhja e një sigurim për përkujdesjen në rast të sëmundjes është e detyrueshme. Arkat e sigurimit shëndetësor janë të detyruara me ligj, t'ju pranojnë ju në sigurimin bazë. Sigurime shtesë janë vullnetare. Ju mund të zgjidhni lartësinë e pagesës dhe vëllimin e përfitimeve të sigurimeve shtesë. Por gjithmonë ka një kontribut vetjak.

### **?** Nga sigurimi bazë paguhen këto kontribute:

- Arka e sigurimit shëndetësor parimisht i merr përsipër të gjitha mjekimet që bëhen nga mjeku apo mjekja. Nëse jo, ju duhet të jeni të njoftuar para mjekimit.
- Sigurimi bazë e paguan trajtimin dhe qëndrimin në repartin e përgjithshëm të spitalit të kantonit Uri dhe 16 spitale të tjera të listës. Shpenzimet shtesë për trajtimin dhe qëndrimin në repartin privat ose gjysmë privat janë në ngarkimin tuaj ose mbulohen nga sigurimi i mundshëm shtesë.
- Sigurimi bazë i merr përsipër shpenzimet për të gjitha medikamentet e detyrueshme të arkave, të cilat jepen me recetë nga një mjek ose një mjekje.
- Sigurimi bazë merr përsipër kostot e trajtimeve të ndryshme që shërbejnë për kujdesin profilaktik shëndetësor (parandalim), siç janë: vaksinimi, 8 kontrollet për fëmijët e moshës parashkollore, kontrollet e kujdesit gjinekologjik çdo tri vjet, dhe mamografite çdo dy vjet tek gratë e moshës mbi 50 vjeçare apo edhe çdo vit tek gratë e rrezikuara.

### **?** Kur e marr unë një reduktim të primeve?

Personat që jetojnë dhe janë siguruar në Zvicër me të ardhura modeste kanë të drejtë për reduktimin e primeve të tyre për arkat e sigurimit shëndetësor. Vendimtare janë të ardhurat

**Informacione për ofertat dhe primet e arkave të ndryshme të sigurimit shëndetësor:**  
[www.bag.admin.ch](http://www.bag.admin.ch)

**Informacione në gjuhë të ndryshme:**  
**«Gesundheitsratgeber»**  
[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch) > Publikationen

**Parandalimi dhe nxitja e shëndetësisë:**  
[www.gesundheitsfoerderung-uri.ch](http://www.gesundheitsfoerderung-uri.ch)



mbi të cilat janë paguar tatime. Kushtet, lartësia e reduktimit dhe procedurat ndryshojnë nga kantoni në kanton. E drejta për reduktimin e primeve llogaritet, si parim, automatikisht. Personat të cilët taten në burim duhet të plotësojnë një formular aplikimi. Ky mund të merret nën [www.ur.ch/praemienverbilligung](http://www.ur.ch/praemienverbilligung), direkt tek Zyra e shëndetit ose tek administrata e komunës suaj të banimit.

### **?** Ku trajtohem unë nga ana mjekësore?

Në varësi nga modeli i zgjedhur i arkës së sigurimit shëndetësor, në Zvicër ju keni ose nuk keni mundësinë e përzgjedhjes së lirë të mjekëve. Adresat e mjekëve dhe mjekëve që praktikojnë ju i gjeni në numërorin lokal ose në internet nën [www.ur.ch](http://www.ur.ch) > Stichwort «Gesundheitsdienste».

### **?** A janë shpenzimet e mia dentale po ashtu të siguruara?

Jo, shpenzimet dentale nuk janë të përfshira në sigurimin bazë (Grundversicherung). Mirëpo, ju mundeni të kontraktoni një sigurim shtesë (Zusatzversicherung) për këto shpenzime.

### **?** A kushtojnë vizitat e fëmijëve të mi te mjeku i shkollës dhe te dentisti i shkollës?


Shkolla fillore gjatë kohës së detyrueshme të shkollimit, në intervale të rregullta, organizon kontrolle mjekësore dhe dentale. Këto kontrolle janë falas!

### **?** A mund të pi ujë në shtëpi nga rubineti?

Po, uji në Zvicër ka një cilësi të mirë dhe është falas. Uji është shuarësi më i mirë dhe më i shëndetshëm i etjes.

**Informacion për zbritjen e primeve:**  
 Amt für Gesundheit, Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf  
 Telefon: 041 875 22 42  
 E-mail: [praemienverbilligung@ur.ch](mailto:praemienverbilligung@ur.ch)  
[www.ur.ch/praemienverbilligung](http://www.ur.ch/praemienverbilligung)

## Shkolla dhe arsimi



Mësimi në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK):  
www.ur.ch > «HSK»

### ? Si duket sistemi shkollor në kantonin e Urit!

Në Zvicër kantonin e Urit rregullon çështjet e shkollës fillore dhe federata ato të shkollës sekondare II dhe të shkollimit terciare.



## Shkolla dhe arsimi

### **?** Si është detyrimi shkollor në Zvicër?

Në Zvicër vijimi i shkollimit fillor (klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të) është i detyrueshëm. Në Uri shkuarja në kopshtin e fëmijëve është vullnetare, mirëpo rekomandohet shumë. Shkolla publike në aspektin fetare është neutrale. Edukimi fetar është çështje e prindërve.

Fëmijët me sfond migrimi mund të ndjekin kurse në gjuhën dhe kulturën e tyre (HSK). Shpeshherë këto kurse organizohen jashtë kantonit Uri si dhe jashtë orarit të rregullt mësimor. Për adresat pyesni në shkollën e vendbanimit tuaj.

### **?** Si përkrahet fëmija im në shkollë për ta mësuar gjuhën gjermane?

Fëmijëve të sapoardhur, si rregull, gjatë një viti apo dy viteve u ofrohet ndihmë intensive mësimore. Ky mësim zhvillohet brenda kohës mësimore.

### **?** Ku duhet të lajmërohem, nëse fëmija im ka vështirësi dhe probleme në shkollë?

Personi i parë i kontaktit është gjithmonë mësuesi i klasës i fëmijës. Në qoftë se është e nevojshme ai ju ndërmjetëson juve tek organet e tjera.

### **?** Çfarë pritet nga prindërit gjatë shkollimit të detyrueshëm të fëmijëve të tyre?

#### Prindërit janë të detyruar:

- që t' u kërkojnë fëmijëve të tyre të përmbushin detyrimin shkollor
- të bashkëpunojnë me shkollën
- t' i shikojnë dëftesat e fëmijëve të tyre dhe t' i nënshkruajnë ato
- t' u përgjigjen ftesave të mësuesve për biseda vlerësuese
- t' i kërkojnë me kohë lejet për pushim, t' i lajmërojnë paraprakisht dispensacionet e veta dhe në rast të mungesave t' i shpjegojnë arsyet

### **?** Çfarë të drejte keni ju si prindër?

#### Prindërit kanë të drejtë:

- të marrin të gjitha informacionet, të cilat janë të nevojshme për të përmbushur të gjitha të drejtat dhe detyrimet prindërore
- të informohen mbi përparimin në mësim dhe sjelljen në punë dhe atë sociale

- të marrin një përfytyrim për arritjet e vlerësuara të fëmijës
- të kenë mundësi për të zhvilluar biseda individuale me mësuesit
- në marrëveshje me mësuesit të marrin një ide për orët mësimore
- të informohen me kohë mbi eksperimentet dhe reformat e shkollës
- në rast të mospasjes shkollë të informohen me kohë
- gjatë kohës së detyrueshme shkollore të ftohen, si rregull, për një mbledhje prindërore gjatë vitit shkollor

### **?** Çfarë ndodh pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm?

Pas shkollimit të detyrueshëm të rinjtë mund të ndjekin një mësim profesional ose një shkollë të mëtejshme (gjimnazin dhe më vonë universitetin).

Në Zvicër mësimi profesional është i dyfishtë, d.m.th. të rinjtë punojnë në një punishte dhe njëkohësisht ndjekin shkollën profesionale për të mësuar përmbajtjet teorike të profesionit dhe të formimit të përgjithshme.

Të dyja rrugët duhet të konsiderohen si të barabarta.

#### Oferta urëlidhëse

Kush pas kohës së detyrueshme të shkollës, nuk e gjen dot rrugën direkte për në një formim profesional bazë ose në një shkollë të mëtejshme, mund të bëjë një vit të ndërmjetëm. Një mundësi e tillë është ndjekja e ofertës urëlidhëse.

Për konsultime paraqituni në këshillimoren për profesion, studime dhe karrierë.

#### B-V-S Oferta urëlidhëse shkollore

B-V-S-ja është ndjekja vullnetare e Klasës së 10-të për parapërgatitje dhe hyrje të suksesshme në arsim profesional ose në shkollë të mëtejshme.

**Informacione për komunat si mbartës të shkollave:**  
[www.bildungsportal-uri.ch](http://www.bildungsportal-uri.ch) > Gemeindeschulen

**A keni ditur se interesimi dhe pjesëmarrja e prindërve në karrierën shkollore të fëmijës së tyre është një nga faktorët më të rëndësishëm për suksesin e tij, i cili ua mundëson një fillim të mirë në jetën profesionale?**

## Shkolla dhe arsimi



### K-B-A Oferta e kombinuar urëlidhëse

K-B-A-ja është një vit përgatitor me synim për të filluar një mësim profesional ose një kualifikim profesional bazë të certifikuar.

### K-B-A Oferta integrative urëlidhëse

Pranohen të rinjtë që flasin gjuhë të huaj, për të cilët, për arsye të moshës (mbi 15 vjeç), ndjekja e mësimin në shkollën fillore është e pamundur, të cilët po ashtu nuk mund të fillojnë një kualifikim profesional bazë, sepse kompetencat e tyre gjuhësore nuk mjaftojnë.



### A mundem unë si person i rritur të shkollohem më tej?

Arsimimi i të rriturve, «të mësuarit gjatë gjithë jetës», për shkak të ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm. Kurset për arsimim të mëtejshëm organizohen nga institucione private dhe publike. Ato u mundësojnë të rriturve të zgjerojnë aftësitë e tyre profesionale dhe jo profesionale.



### A mund të fitoj unë një kualifikim profesional edhe si person i rritur?

Për çdo profesion është e mundshme që me praktikën përkatëse disavjeçare të fitohet edhe më vonë një kualifikim profesional. Ju duhet t' i përvetësoni njohuritë profesionale dhe ato të formimit të përgjithshëm (nëse nuk i keni fituar tanimë gjatë një formimi të parë bazë). Mbi mundësitë e tjera ju mund të informoheni në këshillimin për profesione, studime dhe karrierën ose nën [www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch).



### A njihen diplomat e mia në Zvicër?

Zvicra dhe BE-ja njohin në mënyrë reciproke shkollimet e përfunduara për ato profesione që në disa shtete janë të rregulluara. Qendra Kontaktuese Nacionale pranë Entit Shtetëror për Arsim Profesional dhe Teknologji (BBT) informon mbi procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për miratimin.

Maturat e përfunduara në një vend të huaj nuk njihen në nivel federal. Për t' u lejuar ndonjë studim i mundshëm, drejtohuni drejtpërsëdrejti tek shkollat e larta.

**Sekretariati i Shtetit për Arsim,  
Kërkim dhe Inovacion SBFI:  
Zyra e kontaktit për njohjen e diplomave  
Kontaktstelle Diplomanerkennung**  
Effingerstrasse 27  
3003 Bern  
Telefon: 031 322 28 26  
E-Mail: [kontaktstelle@sbfi.admin.ch](mailto:kontaktstelle@sbfi.admin.ch)  
[www.sbfi.admin.ch/diploma](http://www.sbfi.admin.ch/diploma)

**Swissuniversities – Konferenca e rektorëve  
të shkollave të larta, e shkollave të larta të  
specializuara, universiteteve të Zvicrës dhe Zyra  
e informacionit ETHs për çështjet e njohjes:  
Swiss ENIC**  
Effingerstrasse 15, 3000 Bern  
Telefon: 031 335 07 32  
E-Mail: [communications@swissuniversities.ch](mailto:communications@swissuniversities.ch)  
[www.swissuniversities.ch](http://www.swissuniversities.ch) > Services > ENIC

**Informacione për zgjedhjen e profesionit,  
studimet dhe karrierën:**  
[www.berufsberatung.ch](http://www.berufsberatung.ch)

**Informacione për njohjen e diplomave të huaja:**  
[www.migraweb.ch](http://www.migraweb.ch)  
> Schule und Bildung > ausländische Diplome

**Informacione për ofertat e arsimit të mëtejshëm:**  
[www.bwzuri.ch](http://www.bwzuri.ch) oppure [www.weiterbildung-uri.ch](http://www.weiterbildung-uri.ch)

**Këshillime për profesionin, studimin dhe karrierën:  
Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung**  
Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf  
Telefon: 041 875 20 62  
E-Mail: [biz@ur.ch](mailto:biz@ur.ch), [www.ur.ch/berufsberatung](http://www.ur.ch/berufsberatung)

**A keni ditur që në Uri 80% të absolventeve dhe  
absolventëve të shkollës bëjnë një mësim profesio-  
nal dhe 20% ndjekin një shkollë që çon më tej?**

## Fëmija



### Si është i rregulluar qëndrimi?

Fëmijët e lindur në Zvicër të migranteve dhe migrantëve me leje qëndrimi ose leje të vendosjes kanë të njëjtën leje sikur prindërit.

Kjo e drejtë vlen për fëmijët me prindër nga vendet e treta, përdërisa janë beqarë dhe banojnë së bashku me prindërit e tyre, më së voni deri në ditëlindjen e tyre të 18-të. Pastaj ata duhet të përkujdesen për një leje vetjake të qëndrimit. Për fëmijë me prindër nga vendet e BE-së/ EFTA-s kjo vlen derisa ata të mbushin moshën 21 vjeç.

Pas një shkurorëzimi prindi, i cili ka të drejtën prindërore, ka të drejtë që të vendosë për vendqëndrimin e fëmijës, d.m.th., prindi me të drejtë prindërore mund të kthehet p.sh. në vendlindje dhe mund t' i marrë fëmijët me vete. Prindit që nuk e ka të drejtën prindërore duhet t' i mundësohet e drejta e kontaktit.



### Çfarë është e rëndësishme të dijnë prindërit?

Prindërit janë përgjegjës për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijës së tyre dhe ata marrin vendimet e duhura për këtë. Lidhur me këtë mirëqenia e fëmijës është parësore.

Prindërit duhet të edukojnë fëmijën sipas kushteve të tyre duke e nxitur dhe mbrojtur zhvillimin fizik, mendor dhe moral të tij.

Ata duhet t' i sigurojnë fëmijës një arsim të përgjithshëm profesional që i përgjigjet aftësive dhe prirjeve të tij. Për këtë qëllim ata duhet të bashkëpunojnë me shkollën.

Nëse mirëqenia e fëmijës është në rrezik dhe prindërit nuk kujdesen për ndihmë nga jashtë ose nuk janë në gjendje për këtë, atëherë organet e kujdestarisë marrin masa për mbrojtjen e fëmijës (KESB).

Prindërit duhet të kontribuojnë patjetër për mbajtjen e fëmijës, shkollimin e tij dhe eventualisht për masat për mbrojtjen e fëmijës deri në moshën madhore (18 vjeç), ose deri në përfundim të një kualifikimi të parë.

**A e keni ditur se nxitja për të mësuar gjuhën e parë është një bazë e rëndësishme për të përvetësuar gjuhën lokale?**



### Oferta për përkujdesjen e fëmijëve

«stiftung papilio» është në Uri vendi i kontaktit për çështjet që kanë të bëjnë me jetën e familjes. Oferta përmban përkujdesjen e fëmijëve, tavolinën e drekës dhe oferta social-pedagogjike.

### Grupi i lojës për fëmijët në moshën parashkollore

FGrupet e lojës u ofrojnë fëmijëve nga mosha tre vjeçare, duke luajtur, përfitimin e përvojave të rëndësishme në një grup konstant si bazë për zhvillimin e mirë të personalitetit dhe të të mësuarit. Për informacione dhe adresa në lidhje me ofertat për grupet e lojës, pyesni në komunën e vendbanimit tuaj.

#### Grupet e lojës Spielgruppen

[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «Spielgruppen»

#### Këshillimoret Beratungsstellen

[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «soziale Institutionen»

#### stiftung papilio

Gotthardstrasse 14, 6460 Altdorf

Telefon: 041 874 13 00

E-Mail: [info@stiftung-papilio.ch](mailto:info@stiftung-papilio.ch)

[www.stiftung-papilio.ch](http://www.stiftung-papilio.ch)

#### Këshillimi i nënave dhe baballarëve Uri

#### Mütter- und Väter-Beratung Uri

Rüttistrasse 71, 6467 Schattdorf

Telefon: 041 871 04 04, E-Mail: [info@spitexuri.ch](mailto:info@spitexuri.ch)

[www.spitexuri.ch](http://www.spitexuri.ch)

## Martesa, lindja dhe vdekja

### **?** Çfarë duhet të merret parasysh para martesës?

Zyra kompetente e gjendjes civile e vendbanimit të çiftit të ri jep informacione për dokumentet e nevojshme dhe e organizon ceremoninë martesës civile. Për personat me vendbanim në kantonin e Urit është kompetente zyra e gjendjes civile Uri.

Një ceremoni plotësuese fetare mund të organizohet me Bashkësinë Fetare së cilës i përkisni.

#### **Kushtet për lidhjen e martesës:**

- Ju duhet të jeni 18 vjeç dhe të aftë për të gjykuar
- Ju nuk duhet të jeni tashmë i/e martuar
- Ju duhet të qëndroni legalisht në Zvicër
- Ligji e ndalon lidhjen e martesës midis (gjysmë) vëllë-zërve/motrave me nënë ose baba tjetër ose me prindërit (prindërit biologjikë ose prindërit e birësimit) ose gjyshin dhe gjyshen si dhe midis një personi dhe fëmijës së bashkëshortit (madje edhe në rast se martesa është deklaruar e pavlefshme ose e zgjidhur).
- Dokumente të tjera sipas të dhënave të zyrës së gjendjes civile

Martesa të detyruara janë të ndaluara në Zvicër.



### **?** Çfarë duhet të merret parasysh gjatë lindjes?

Pas lindjes së një fëmije, kjo duhet të njoftohet në zyrën e gjendjes civile të vendit të lindjes. Në rast të një lindjeje në shtëpi, duhet të silllet po ashtu me vete formulari për njoftimin e lindjes që është i plotësuar nga mamia. Në rast të lindjeve në spitalin e kantonit Uri njoftimi bëhet direkt nga spitali.

Një ceremoni fetare duhet të organizohet me bashkësinë e vet fetare.



#### **Zyra e gjendjes civile Uri Zivilstandsamt Uri**

Marktgasse 6, 6460 Altdorf  
Telefon: 041 875 22 80  
E-mail: [zivilstandsamt@ur.ch](mailto:zivilstandsamt@ur.ch)

#### **Informacione për lidhjen e martesës:**

[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «Zivilstandsamt»

#### **Informacione për lindjen:**

[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «Zivilstandsamt»

## Martesa, lindja dhe vdekja



### Çfarë duhet të merret parasysh në rast vdekjeje?

Në rast vdekjeje certifikata e vdekjes duhet të plotësohet nga një mjek. Pastaj, pa vonesë, rasti i vdekjes duhet t' i njoftohet komunës përgjegjëse në Altdorf, zyrës së gjendjes civile Uri. Nëse vdekja ka ndodhur në një spital, shtëpi pleqsh apo shtëpi kujdesi, atëherë drejtoria e këtij institucioni është e detyruar për njoftimin e vdekjes. Përndryshe të afërmit janë të detyruar të bëjnë njoftimin e vdekjes.

Për transferimin në kishën e vogël të varrezave ose në krematorium duhet të ngarkohet një ndërmarrje varrimi. Nëse dëshirohet, kjo e merr përsipër edhe transferimin e një kufome jashtë vendit ose nga jashtë vendit. Shpenzimet për varrimin mbahen nga të pasjetuarve.

Për njoftimin e rasteve të vdekjes në komunën e vendit të vdekjes duhet të sillni me vete këto dokumente:

- vërtetimin mjekësor të vdekjes
- nëse ekziston librin gjenealogjik
- pasaportën ose kartën ID dhe letërnjoftimin për të huajt.
- Zyra e gjendjes civile Uri jep informacione se cilat dokumente të tjera nevojiten akoma (certifikatë lindjeje, certifikatë martese, etj.)

Një ceremoni fetare duhet të organizohet me bashkësinë vetjake fetare.

Për bashkësitë jo të krishtere në Uri nuk ekzistojnë varreza speciale.

### Feja

Kushtetuta e kantonit të Urit e garanton lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes. Secili person mund të vendosë lirshëm, nëse ai dëshiron të jetë besimtar apo cilën fe dëshiron të praktikojë. Askush nuk duhet të detyrohet për ushtrimin e fesë. Liria e fesë është atëherë një e drejtë individuale të cilën secili person e ushtron lirshëm sipas bindjeve personale. Por është e rëndësishme megjithatë që në Zvicër shteti qëndron para fesë. Liria e fesë është e garantuar për atë që nuk cenon asnjë prej ligjeve zvicerane apo kantonale.

Një listë mbi bashkësitë fetare në Uri mund të kërkonte tek qendra e kontaktit për çështjet e integritit.

#### Qendra e kontaktit për çështjet e integritit

#### Ansprechstelle für Integrationsfragen

Klausenstrasse 4  
6460 Altdorf  
Telefon: 041 875 20 66  
E-Mail: [integration@ur.ch](mailto:integration@ur.ch)  
[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «Integration»

#### Informacione rreth temës 'vdekje':

[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «Zivilstandsamt»

**A e keni ditur se kultura e krishterë perëndimore në kantonin e Urit është e ankoruar në traditat dhe jetën e përditshme?**

## Jeta e përditshme dhe koha e lirë

### **?** Cilat oferta për kohën e lirë kam unë këtu?

Në fletushkën për shpallje falas «Uristier» si dhe në gazetat regjionale do të gjeni të dhëna për aktivitete. Në internet, nën [www.uri.ch](http://www.uri.ch), mund të gjeni informacione të përmblhedhura për aktivitete kulturore, sportive dhe të tjera si dhe për oferta.

Në Uri po ashtu ka shumë shoqata. Për të dhënat rreth shoqatave pyesni tek sekretariati i vendbanimit tuaj ose shikoni në [www.urionline.ch](http://www.urionline.ch)

### Sporti

Peisazhi malor alpin dhe liqeni 'Vierwaldstättersee' ju ofrojnë një mori mundësish për aktivitete të jashtme në Uri Gjithashtu në shumë komuna ka edhe shoqata sportive apo ofertues privatë të ofertave të lira sportive. Për adresat informohuni në komunën e vendbanimit tuaj apo edhe në zyrën e turizmit ose në seksionin e sportit të drejtorisë për arsim dhe kulturë.



### Informacione mbi shoqatat:

[www.urionline.ch](http://www.urionline.ch)

### Informacione për muzetë:

[www.museen-uri.ch](http://www.museen-uri.ch)

### Informacione për vendet e lojërave:

[www.spielplatz-uri.ch](http://www.spielplatz-uri.ch)

### Huadhënia për lojëra për fëmijë, familje, të rinjtë dhe të rriturit:

#### Ludothek Altdorf

Seedorferstrasse 1  
6460 Altdorf  
Telefon: 041 871 00 05  
[www.ludothek-altdorf.ch](http://www.ludothek-altdorf.ch)

### Drejtoria për Arsim dhe Kulturë:

#### Bildungs- und Kulturdirektion

Abteilung Sport  
Klausenstrasse 46460 Altdorf  
Telefon: 041 875 20 64  
E-mail: [sport@ur.ch](mailto:sport@ur.ch)  
[www.ur.ch/sport](http://www.ur.ch/sport)

### Traditat

Në Kantonin e Urit ekziston një ofertë atraktive për manifestime kulturore. Nëpër komuna dhe në kanton u kushtohet kujdes zakoneve kishtarë dhe laike. Mes të tjerave festohen festa fetare, viti kishtar dhe rituale të ciklit jetësor (lindja, e Diela e Bardhë, martesja, gjithashtu koha e agjërimit, Pashkët, Rrëshaja apo të pesëdhjetat, Advent, Kërshëndellat etj.). Të rëndësishme janë gjithashtu kulmet festive të shoqërisë (jubiletë, festat komunale, festimet politike) si dhe manifestimet tradicionale siç janë karnevali, festa e 1 Gushtit, festa e Kilbit (Panagyrit) apo, herë pas here, manifestimet e shoqatave si aktivitete teatrore, koncerte muzikore, festimi i përmbylljes së vitit shkollor etj.

### Turizmi në Uri

#### Uri Tourismus

Tellspielhaus, Schützengasse 11, 6460 Altdorf  
Telefon: 041 874 80 00  
E-mail: [info@uri.info](mailto:info@uri.info)  
[www.uri.info](http://www.uri.info)

**Mundja është një sport tradicional zviceran, që tek popullsia ka një jehonë të madhe. Rregullisht zhvillohen festa të mundjes në nivelin e kantonit ose të federatës.**

## Mobiliteti

### **?** Si funksionon komunikacioni publik?

Zvicra posedon një prej rrjeteve më të dendur të komunikacionit publik në botë.

Hekurudha Federale e Zvicrës (SBB), në Kantonin e Urit plotësohet me autobusët dhe makinat e postës së 'Auto AG Uri'.

Me një abonim 'Halbtax' hekurudha, autobusët dhe anijet në të gjithë Zvicrën mund të përdoren me një çmim të reduktuar.

### **?** Çfarë duhet të marr parasysh për drejtimin e një makine ose motoçiklete

Një patentë zvicerane u nevojitet drejtuesve të automjeteve nga jashtë Zvicrës,


- të cilët banojnë që prej 12 muajve në Zvicër dhe gjatë kësaj kohe nuk kanë qëndruar më shumë se tre muaj pa ndërprerje jashtë vendit;
- të cilët për shkak të profesionit drejtojnë automjete të regjistruara në Zvicër të kategorisë së patentave C ose D ose të nënkategorive C1 ose D1 ose kanë nevojë për një leje për transportimin profesional të personave;
- nëse kohëzgjatja e vlefshmërisë së patentës së huaj ka skaduar.

Për të marrë një patentë zviceran duhet të paraqiten këto dokumente:

- formularin e plotësuar tërësisht dhe të nënshkruar
- dëshminë e vendbanimit
- lejen e qëndrimit ose lejen e vendosjes
- origjinalin e patentës
- fotografi pasaporte aktuale me ngjyra
- dëshminë e testimit të syve tek optiku

Për vozitjen e motoçikletës mbajtja e helmetës është e detyrueshme!

**Zyra e qarkullimit rrugor Uri**  
**Strassenverkehrsamt Uri**  
 Gotthardstrasse 77a  
 6460 Altdorf  
 Telefon: 041 875 28 00  
 E-Mail: assv@ur.ch  
 www.ur.ch > «Amt für Strassen-  
 und Schiffsverkehr»



### **?** Çfarë duhet të kem parasysh, kur jam duke ecur me biçikletën?

Rregullat e komunikacionit vlejnjë edhe për biçiklistet dhe biçiklistët. Në parim nuk kërkohet një provim. Para arritjes së moshës së shkollimit të detyrueshme fëmijët nuk duhet të ecin me biçikletë në qarkullim rrugor.

Për dëmet që shkaktohen nga një çikliste ose një çiklist mban përgjegjësi tani sigurimi privat i përgjegjësisë ndaj palës së tretë, nëse ky person ka një sigurim të tillë. Kush nuk ka një sigurim të përgjegjësisë ndaj palës së tretë duhet t' i paguaj vetë dëmet e shkaktuara. Kjo mund të bëhet e shtrenjtë. Prandaj ia vlen që të lidhet një sigurim privat i përgjegjësisë ndaj palës së tretë.

Rekomandohet bartja e një helmete për biçiklistët.

#### Informacione për komunikacionin publik:

www.sbb.ch (tren, autobus, anije, teleferik)  
 www.aagu.ch (autobus)  
 www.seilbahnen-uri.ch (teleferikë)  
 www.lakelucerne.ch (anije)

**A e keni ditur se në Uri ka 39 teleferikë,  
 shfrytëzimi i të cilëve është i hapur?  
 Zbuloni botën tonë malore!**

## Gjuha dhe ofertat për mësimin e gjuhës

### **?** Ku mund të mësoj unë gjermanisht?

Për të lëvizur lirshëm dhe i pavarur në Uri është e domosdoshme të mësohet gjermanishtja. Kjo ju lehtëson juve të keni kontakt me fqinjët, me mësuesit e fëmijëve tuaj, me autoritetet dhe persona të tjerë.

Informacione mbi ofertat për kurset aktuale të gjermanishtes për fillestare dhe fillestarë mund t' i merrni tek:

#### **Qendra për arsimin profesional dhe të mëtejshëm Uri:**

##### **Berufs- und Weiterbildungszentrum Uri**

Attinghauserstrasse 12, 6460 Altdorf

Telefon: 041 875 20 70

E-mail: [bwz@bwzuri.ch](mailto:bwz@bwzuri.ch), [www.bwzuri.ch](http://www.bwzuri.ch)

#### **S&I Gjuha dhe integrimi:**

##### **S&I Sprache und Integration**

Regula Wyss, Bahnhofstrasse 38, 6460 Altdorf

Telefon: 041 871 34 93

E-Mail: [info@sprache-integration.ch](mailto:info@sprache-integration.ch)

[www.sprache-integration.ch](http://www.sprache-integration.ch)

### **?** A është me rëndësi të mësoj gjermanishten zvicerane?

Që në jetën tuaj të re të mund të orientoheni mire, mjafton gjuha gjermane. Zviceranët dhe zviceranët janë të vetëdijshëm se sa vështirë është të mësohet gjermanishtja zvicerane me dialektet e saj të ndryshme.

### **?** Si mund të gjej një përkthyes apo një përkthyes?

Për biseda të vështira dhe të rëndësishme rekomandohet angazhimi i përkthyesi të kualifikuar ose i një përkthyesjeje të kualifikuar. Këta ndërmjetësohen përmes Shërbimit për Përkthim të Zvicrës Qendrore.

#### **Shërbim për përkthime**

##### **Caritas Luzern**

Brünigstrasse 25, 6002 Luzern

Telefon: 041 368 51 51, Fax: 041 368 52 88

(me sekretari telefonike jashtë orarit të punës)

E-mail: [info@dolmetschdienst.ch](mailto:info@dolmetschdienst.ch)

[www.dolmetschdienst.ch](http://www.dolmetschdienst.ch)



### **?** Si mund të integrohem më së miri?

Njëri prej faktorëve kryesorë për integrimin e suksesshëm është gjuha gjermane. Kush mund të komunikojë, të rrëfejë dhe të orientohet në mënyrë të pavarur gjen më mirë qasjen në jetën e përditshme të Urit. Ndihmuese është edhe pjesëmarrja aktive në jetën shoqërore të vendbanimit dhe kantonit tuaj. Mundësi për këtë ofrojnë shoqatat, traditat dhe manifestimet e shumta.

Shih «Jeta e përditshme dhe koha e lirë»

#### **Huadhënia për librat në gjermanisht dhe në gjuhë të tjera:**

Kantonsbibliothek, Bahnhofstrasse 13, 6460 Altdorf

Telefon: 041 875 22 21

E-Mail: [kantonsbibliothek@ur.ch](mailto:kantonsbibliothek@ur.ch)

[www.kbu.ch](http://www.kbu.ch)

**A e keni ditur se gjuha është njëra prej kompetencave kyçe për një integrim të suksesshëm?**



## Ditët e festave

Viti i Ri	Neujahrstag	1 janari
Tre Mbretërit e Shenjtë	Heilige Drei Könige	6 janari
Dita e Shën Jozefit	St. Josefstag (Seppitag)	19 marsi
E Premtja e Madhe	Karfreitag	e premtja para pashkëve
Pashkët	Ostern	e diela e parë pas hënës së plotë pranverore
E Hëna e Pashkëve	Ostermontag	e hëna pas pashkëve
Zoja Ndhimëtare	Auffahrt	një të enjte, 10 ditë para rrëshajëve
Rrëshajët	Pfingsten	në një të diel, 49 ditë pas pashkëve
E Hëna e Rrëshajëve	Pfingstmontag	pas së dielës së rrëshajëve
Korpi i Krishtit	Frohnleichnam	një të enjte, 11 ditë pas rrëshajëve
Festa kombëtare	Bundesfeiertag	1 gushti
Shkuarja e Shën Marisë në qiell	Maria Himmelfahrt	15 gushti
Të gjithë të Shenjtit	Allerheiligen	1 nëntori
Zoja e Papërlyer	Maria Empfängnis	8 dhjetori
Kërshëndellat	Weihnachten	25 dhjetori
Dita e Stefanit	Stephanstag	26 dhjetori

E drejta për ditët e festave bazohet në përcaktimet kantonale, të degës së punës dhe kontratës përkatëse të punës.

**A e keni ditur se shumica e ditëve të festave të njohura në kantonet kanë sfond të krishtere?**

## Adresa ndihmëse

### Këshillimoret

Një vështrim të përgjithshëm mbi këshillimoret në kanton Uri gjeni nën:

[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «soziale Institutionen»

### Këshillime dhe ndihmë për familjet

**Zyrë e specializuar për çështjet familjare**

**Fachstelle Familienfragen**

Stiftung Papilio, Gotthardstrasse 14, 6460 Altdorf

Telefon: 041 874 13 15, E-Mail: [info@stiftung-papilio.ch](mailto:info@stiftung-papilio.ch)

**Këshillime martesore, familjare dhe jetësore**

**Psychotherapeutische Praxis für Einzelne,**

**Paare und Familien**

Telefon: 041 870 00 65

E-Mail: [info@psychotherapie-uri.ch](mailto:info@psychotherapie-uri.ch)

[www.psychotherapie-uri.ch](http://www.psychotherapie-uri.ch)

**Përkujdesja social-pedagogjike për familjet**

**Stiftung Papilio**

Gotthardstrasse 14, 6460 Altdorf

Telefon: 041 874 13 15

E-Mail: [info@stiftung-papilio.ch](mailto:info@stiftung-papilio.ch)

[www.stiftung-papilio.ch](http://www.stiftung-papilio.ch)

**Këshillime në çështjet e edukimit**

**Schulpsychologischer Dienst**

Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf

Telefon: 041 875 20 90

E-Mail: [schulpsychologie@ur.ch](mailto:schulpsychologie@ur.ch)

[www.ur.ch/spd](http://www.ur.ch/spd)

### Këshillime për të rinjtë dhe të rritur të rinj

**Këshillime dhe përkujdesje për njerëzit me probleme të varësisë dhe këshillime për të rinjtë**

**kontakt uri**

Gemeindehausplatz 2, 6460 Altdorf

Telefon: 041 874 11 80

E-mail: [mail@kontakt-uri.ch](mailto:mail@kontakt-uri.ch)

[www.kontakturi.ch](http://www.kontakturi.ch)

**Këshillime për fëmijë dhe të rinj**

**Fachstelle Kinderschutz**

Klausenstrasse 4, 6460 Altdorf

Telefon: 041 875 20 40

E-Mail: [kinderschutz@ur.ch](mailto:kinderschutz@ur.ch)

[www.ur.ch](http://www.ur.ch) > «Kinderschutz»

**JUSES0 Kujdes i përshtirshëm për të rinjtë Uri**

**JUSES0 Jugendseelsorge Uri**

Kirchplatz 3, 6460 Altdorf

Telefon: 041 871 20 56, E-Mail: [juseso@kath-uri.ch](mailto:juseso@kath-uri.ch)

[www.kath-uri.ch/Jugendseelsorge](http://www.kath-uri.ch/Jugendseelsorge)

Informacione në gjuhë të ndryshme për jetën në Zvicër:

Migraweb – [www.migraweb.ch](http://www.migraweb.ch)

### Psikiatra sociale dhe psikiatra

**Shërbimi social-psikiatrik**

**Sozialpsychiatrischer Dienst**

Seedorferstrasse 6, 6460 Altdorf, Telefon: 041 874 00 20

E-Mail: [info@spduri.ch](mailto:info@spduri.ch), [www.spduri.ch](http://www.spduri.ch)

### Mbështetje për personat me nevojë për ndihmë në jetën e përditshme

**Kryqi i Kuq Zvicëran**

**Schweizerisches Rotes Kreuz**

Kantonalverband Uri

Rynächtstrasse 13, 6460 Altdorf

Telefon: 041 874 30 75

E-mail: [info@srk-uri.ch](mailto:info@srk-uri.ch)

### Vendi i kontaktit për njerëzit në gjendje emergjente

**Qendra ndihmuese e kishave Uri**

**Hilfswerk der Kirchen Uri**

Seedorferstrasse 6a, 6460 Altdorf

Telefon: 041 870 23 88

E-mail: [info@hilfswerkuri.ch](mailto:info@hilfswerkuri.ch)

### Përkujdesja për të sëmurët, përkujdesja shëndetësore në shtëpi, ndihma familjare, këshillimi i nënave dhe baballarëve

**Spitex Uri**

Rüttistrasse 71, 6467 Schattdorf

Telefon: 041 871 04 04

E-mail: [info@spitexuri.ch](mailto:info@spitexuri.ch)

[www.spitexuri.ch](http://www.spitexuri.ch)

### Adresa për rastet e emergjencës

**Policia: 117**

**Zjarrëfikësi: 118**

**Saniteti: 144**

**Shërbim dental në rastin urgjent: 1811**

**Shërbimi emergjent mjekësor: 041 870 03 03**

Në rast të njoftimi të një emergjence kini kujdes që të jepni këto informacione:

- Mbiemri dhe emri
- Ku është vendi?
- Çfarë ka ndodhur?
- Cili është numri juaj i thirrjes [telefonike]?